



**Kuvendi i Komunës Klinë**

01Nr. 06-32262 /2024

Datë: 24.09 /2024

*Duke u bazuar ne nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nr.03/L-040, publikuar ne Gazetën Zyrtare, nr.28/2008, nenin 25 paragrafi 6 të Ligjit për Dhënie ne Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme te Komunës, nr.06/L-092 publikuar ne Gazetën Zyrtare, nr. 10/2019, nenin 31 paragrafi 2 të Rregullores se QRK-së nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave te Dhënies ne Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës se Paluajtshme te Komunës, dispozitat e nenit 10 të Statutit te Komunës se Klinës, nr. 01-110-1232/2010 te miratuar me datën 31.03.2010. Me rekomandimin e KPF-së, pas shqyrtimit te propozimit te nënkryetares te Komunës, nr.01-463-31160/24 te datës 12/09/2024, Kuvendi i Komunës se Klinës ne seancën e VIII-të të rregullt te për vitin 2024 te mbajtur më datë 20.09.2024, mori këtë:*

**VENDIM**

*Për miratimin e propozimit te nënkryetares se komunës për këmbim te pronës se paluajtshme te komunës me prone private*

1. Miratohet, Propozimi i nënkryetares te komunës se Klinës, **nr. 01-463-31160/2024** i datës **12/09/2024** qe ka te bej me këmbimin e pronës se paluajtshme te komunës se Klinës, me pronën e paluajtshme ne pronësi te personit juridik Era Invest L.L.C me drejtor menaxhues Sokol Elezaj nga fshati Gjurgjevik i Vogël Komuna e Klinës.
2. Prona e paluajtshme komunale e cila i jepet ne emër te këmbimit personit juridik Era Invest L.L.C me drejtor menaxhues Sokol Elezaj, është pjesa e parcelës kadastrale, P-71006024-00541-2, ZK Kline, me sipërfaqe 55 m<sup>2</sup>, me kulture e klasit te trete, vendi i quajtur fshati, e evidentuar ne emër të Komunës se Klinës.
3. Prona private e cila merret ne emër te këmbimit është pjesa e parcelës kadastrale P-71006024-00541-1 ZK Kline, me sipërfaqe prej 55 m<sup>2</sup>, me kulture e klasit te trete, vendi i quajtur fshati, e evidentuar ne emër te personit juridik Era Invest L.L.C me numër unik identifikues 811930157 me drejtor menaxhues Sokol Elezaj.
4. Këmbimi i pronës se paluajtshme behet me qellim të realizimit të planit rregullues për realizimin e qëllimit të ligjshëm publik realizimi i projektit zgjerimi i rrugës, rregullimi i trotuarit dhe ndriçimit publik, si dhe duke marrë parasysh gjendjen faktike në Hartën Zonale të Komunës.
5. Me rastin e hyrjes ne fuqi te këtij vendimi, autorizohet nënkryetarja e komunës të nënshkruaj kontratën e këmbimit duke specifikuar te drejtat dhe obligimet e palëve.

6. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet nënkryetarja e komunës në bashkëpunim me drejtorin për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi.
7. Ky vendim hyn në fuqi 15 dite pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së konform nenit 81 të LVL-së, përkatësisht 7 dite pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës e Klinës.

**Me këtë vendim njoftohen:**

- **MAPL;**
- **Nënkryetarja e Komunes;**
- **Pronarët;**
- **Drejtoria për Kadaster Gjeodezi dhe Pronësi;**
- **Zyra për Informim;**
- **Arkivi.**



**Kryesues i Kuvendit**  
**Fadil Gashi**